

VENDIM
Nr. 434, datë 10.6.2026

**PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE INSPEKTOR EDISON MITAT ADRI,
PUNONJËS POLICIE, I PLAGOSUR NË KRYE TË DETYRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 14, të ligjit nr. 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”, dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e ndihmës financiare, prej 3 000 000 (tre milionë) lekësh, inspektor Edison Mitat Adri, punonjës policie, në Drejtorinë Vendore të Policisë Korçë, i plagosur në krye të detyrës.
 2. Fondi i përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.
 3. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçiu